# DËSHMI ARKIVI

**A-454637**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Edi Rama, kryeministri me rrogën më të lartë në rajon, ankohet për pagat e gjyqtarëve |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/edi-rama-kryeministri-me-rrogen-me-te-larte-ne-rajon-ankohet-per-paga-i104805` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 10:11:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 09:59:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4b954e39146a2105bd8c2f93ab92cea4ffeaab26a252ff467ff61bb3b05d4bb9` |
| TEKSTI | `2306db9697e6cb69356717dc384ddd9229808ad1554bd3535767b4330bf17501` |
| PAMJA | `5c65dc1417f6b80c9935af677a7cf34ba500dda1de14ef2b40dcc9b65edae764` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8373c213ae161ab0ef5973826f4e78849a4ce36fcb87df85a49cdec45631fea4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5f16ab6556ceb0058bf60cb7198a73729e9daa0d09a0a505b3785d533f275135` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8373c213ae161ab0ef5973826f4e78849a4ce36fcb87df85a49cdec45631fea4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Edi Rama, kryeministri me rrogën më të lartë në rajon, ankohet për pagat e gjyqtarëve

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 11:59



Sa herë që Edi Rama është në vështirësi politike, siç i ka ndodhur aktualisht me protestën mbi 100-ditore dhe skandalet e shpërndara nga ish-zëvendësi i tij, Arben Ahmetaj, kryeministri sajon nga një "kundërshtar".

Kur nuk ndodh që "fajin e ka Saliu", ai krijon ndonjë konflikt me sistemin e drejtësisë. Këtë betejë po zhvillon së fundmi me gjyqtarët, pasi këta të fundit kërkojnë indeksimin e pagës së tyre, sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Këtë të Dielë, Rama u shfaq në rrjete sociale, ku deklaroi: *"Me rritjen e kërkuar me llogarinë vetë Zot vetë Shkop, paga mesatare e gjyqtarëve bëhet më e lartë se në Greqi, Rumani e Slloveni dhe 140% më e lartë se në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa në raport me administratën shqiptare ajo kërcen në 470% më shumë…"*.

Me populizmin që e karakterizon, Edi Rama paraqiti shifrat e gjyqtarëve shqiptarë, krahasuar me ato të vendeve të rajonit. Megjithatë, ai nuk ka bërë asnjëherë një krahasim të tillë, për pagën e vetë.

Referuar të dhënave të përpunuara nga "Chatgpt", një platformë që edhe Rama e përdor herë pas here, për të shpërndarë informacion statistikor që i shkojnë në vijën e tij politike.

Sipas informacionit të platformës, rezulton se Edi Rama, pra kryeministri i Shqipërisë, ka pagën më të lartë, krahasuar me të gjithë homologët e tij në Ballkanin Perëndimor. Përjashtim bën vetëm Greqia, e cila, është e vetmja anëtarë e Bashkimit Europian në zonën tonë. Të dhënat më poshtë jepen në shifra bruto, pra pagat para se të paguhen taksat.

Në bazë të të dhënave publike, rezulton se **Edi Rama** ka pagë mujore mesatare bruto rreth 4 mijë euro, ose rreth 48 mijë euro në vit.

| EU Shteti | Paga mujore e kryeministrit | Bashkëndaj |
|---|---|---|
| □□ Shqipëri | ~€4,000 | ~€48,000 |
| □□ Maqedoni e Veriut | ~€2,280 | ~€27,360 |
| GR Greqi | ~€8,285 | ~€99,420 |

| | | |
|---|---|---|
| □□ Mali i Zi | ~€2,061 | ~€24,732 |
| □□ Kosovë | ~€2,950 | ~€35,400 |
| RS Serbi | ~€1,800 | ~€21,600 |

Disa sqarime të rëndësishme:

- □□ **Shqipëria:** paga e kryeministrit u rrit në rreth **400 mijë lekë bruto/muaj**, sipas reformës së pagave.
- □□ **Maqedonia e Veriut:** paga e kryeministrit është raportuar **140,450 denarë**, rreth **€2,280/muaj.**
- GR **Greqia:** shifra e referencës për postin e kryeministrit është **€99,420/vit.** Ndërkohë, deklarata e pasurisë së Kyriakos Mitsotakis për vitin fiskal 2024 tregoi €81,674 të ardhura totale, pasi të ardhurat reale përfshijnë edhe burime të tjera dhe nuk janë e njëjta gjë me pagën nominale të postit.
- □□ **Mali i Zi:** të dhënat më të fundit tregojnë se Milojko Spajić mori **€2,061 në gusht 2026**, pra rreth **€24,732/vit** nëse mbetet në këtë nivel.
- □□ **Kosova:** paga e përcaktuar për kryeministrin është rreth **€2,950/muaj**, ose **€35,400/vit**. Përveç kësaj, në 2026 u miratua edhe paga e 13-të për punonjësit e paguar nga buxheti i shtetit, ndaj një krahasim strikt i të ardhurave vjetore duhet ta marrë parasysh këtë.
- RS **Serbia:** paga e raportuar për kryeministrin është rreth **211,000 dinarë / €1,800 në muaj**, ose rreth **€21,600/vit.**

Renditja sipas pagës vjetore

1. GR Greqia — ~€99,420
2. □□ Shqipëria — ~€48,000
3. □□ Kosova — ~€35,400
4. □□ Maqedonia e Veriut — ~€27,360
5. □□ Mali i Zi — ~€24,732
6. RS Serbia — ~€21,600

Në foto: Të dhënat e "Chatgpt". Rama ka pagën më të lartë në rajon

Në foto: Të dhënat e "Chatgpt". Rama ka pagën më të lartë në rajon

Në vendin e dytë renditet kryeministri i Kosovës, **Albin Kurti**. Paga e tij mujore bruto llogaritet në rreth 2950 euro në muaj ose për një total prej 35.400 euro në vit.

**Hristian Mickovski**, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, paguhet me një rrogë mujore në shumën 2280 euro. Në vit, paga e tij zyrtare përllogaritet në vlerën 27.360 euro, duke i renditur në vendin e tretë.

Kryeministri i Malit të Zi, **Milojko Spajiç** vijon listën, në vendin e katërt, me pagë mujore bruto në shumën 2061 euro, një shumë që në një vit arrin në një total afërsisht 24.732 euro.

Lista e pagave për drejtuesit politik të Rajonit mbyllet me Presidentin e Serbisë, **Aleksandër Vuçiç**. Të dhënat e përpunuara nga "Chatgpt" tregojnë se ai paguhet me një rrogë mujore në shumën rreth 2051 euro. Në vit, Vuçiç përfiton pagë bruto në vlerën 21.600 euro.

"***Boldnews.al***" kërkoi të dhëna edhe lidhur me sa herë më e lartë ishte paga e kryeministrave të Rajonit, në krahasim me të ardhurat mesatare të qytetarëve të vendeve të tyre.

Duke përjashtuar sërish Greqinë, rroga e kryeministrit shqiptar, Edi Rama, rezulton se është më e larta, krahasuar me të ardhurat mesatara të vendit.

Për të qenë sa më korrekt, po përdor të dhënat më të fundit të disponueshme për pagat mesatare dhe, ku është e mundur, të dhënat zyrtare. Ka një kufizim: disa vende publikojnë pagën **neto**, ndërsa të tjera **bruto**, ndaj raportet janë orientuese dhe jo një krahasim perfekt.

| Shteti | Paga e kryeministrit / muaj | Paga mesatare / muaj | Kryeministri merr rreth |
|---|---|---|---|
| GR Greqi | ~€8,285 | ~€1,342 | 6.2× |
| □□ Shqipëri | ~€3,640 | ~€850 | 4.3× |
| □□ Kosovë | ~€2,950 | €713 | 4.1× |
| □□ Maqedoni e Veriut | ~€2,280 | ~€746 | 3.1× |
| □□ Mali i Zi | €2,061 | €1,037 | 2.0× |
| RS Serbi | ~€1,800 | ~€1,030 | 1.7× |

Pra, renditja është:

1. GR Greqia — 6.2 herë
2. □□ Shqipëria — 4.3 herë
3. □□ Kosova — 4.1 herë
4. □□ Maqedonia e Veriut — 3.1 herë
5. □□ Mali i Zi — 2.0 herë
6. RS Serbia — 1.7 herë

Në foto: Të dhënat e "Chatgpt". Rama ka pagën më të lartë në rajon, në krahasim me rrogat mesatare

Paga e **Edi Ramës** rezulton se është 4.3 herë më e lartë se sa paga mesatare vjetore në vend.

Në Kosovë, kryeministri **Albin Kurti** rezulton se ka një rrogë 4.1 herë më të lartë se mesatarja e shtetit që drejton.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut llogarit një pagë 3.1 herë më të lartë se sa rroga mesatare e vendit të tij.

Më tej, kryeministri malazez, **Milojko Spajiç** e ka pagën 2 herë më të lartë se rroga mesatare në atë vend.

Në Serbi, **Aleksandër Vuçiç** ka një pagë, afërsisht 1.7 herë më të lartë se sa rroga mesatare e serbëve të punësuar./Bold News.al

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 18 Shtator11:53

**Arrestohen në Itali dy shqiptarë, ja për çfarë akuzohen**

Policia italiane ka arrestuar dy shqiptarë të cilët kërkohen nga drejtësia në vendin tonë pasi akuzohen për vepra t&eu...

AKTUALITET 18 Shtator11:32

**Ergys Agasi dhe shoferi i tij ish-drejtues policie të pakënaqur nga burgimi, kërkojnë në Apel masë më të butë**

Ish-drejtori policisë Ulian Shpataraku dhe Ergys Agasi kanë ankimuar në Apelin e Posaçëm masën e sigurisë "arrest në...

AKTUALITET 18 Shtator11:08

**[“Të plasi tr*pi”/ Çfarë zbulojnë email-et e Ballukut për vilën në Green Coast]**

Vendimi i GJKKO-së për sekuestrimin e vilës në kompleksin “Green Coast” përmban një numër komunikimesh dhe emai...

AKTUALITET 18 Shtator11:03

**[Përfshihet nga flakët automjeti në një parkim nëntokësor në Fier, banorët në panik]**

Një automjet tip “Mercedes-Benz “ është përfshirë nga flakët paraditen e sotme në hyrjen e parkimit nëntok...

AKTUALITET 18 Shtator11:00

**[Iu plagos kolegu, avokatët në Durrës bojkotojnë për dy orë seancat gjyqësore]**

Avokatët kanë pezulluar aktivitetin në shenjë proteste pas plagosjes me armë të kolegut të tyre, Elton Shllaku. Ata kë...

AKTUALITET 18 Shtator09:52

**[U ndaluan gjatë tensioneve para Parlamentit, lirohen 25 protestuesit]**

25 protestuesit, që u shoqëruan një ditë më parë në komisariat gjatë tensioneve në tubimin e djeshëm pë...

AKTUALITET 18 Shtator09:37

**[Bllokimi i pagave të magjistratëve/ Drejtoresha e Thesarit, Elmira Peto merret në pyetje nga SPAK]**

SPAK ka marrë në pyetje drejtoreshën e Thesarit, Elmira Peto, në lidhje me bllokimin e pagave të magjistratëve. Elmira...

Nga Xhuljan Ferzaj AKTUALITET 18 Shtator09:10

**[VIDEO/ Denoncimi i banorit nga Frakulla e Madhe: Mbeturinat hidhen përpara shtëpive]**

Një qytetar nga fshati Frakull e Madhe, në rrethin e Fierit, ka dërguar një denoncim në redaksinë e Piranjat News, ku ankohet p&...

AKTUALITET 18 Shtator08:28

**[Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera]**

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 79.4 lekë dhe do shitet me 80.4 lekë. Ndërk...

AKTUALITET 18 Shtator08:25

**[Nga Lazarati te Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri]**

Një dekadë më parë, Europol e konsideronte Shqipërinë një prej burimeve kryesore të kanabisit që trafikohej drejt...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 17 Shtator

**[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jet...]**

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

BOTA 17 Shtator

**[I veshur si grua, 33-vjeçari ‘tradhtohet’ dhe a...]**

Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, ...

AKTUALITET 17 Shtator

**[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...]**

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në  rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues]**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

**video**



**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.